



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 300/4 Prot

Tiranë, më 15.07.2022

V E N D I M

Nr. 108, datë 15.07.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt për vlerësimin e ligjshmërinë të procedurës së konkurrimit me kod # 4019, të realizuar nga ana e Komitetit të Pranimit për Lëvizje Paralele (KPLP), në Drejtorinë Juridike, në Departamentin Administrativ, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet nga nëpunësja ***** për skualifikim të padrejtë për të marrë pjesë në një procedurë të lëvizjes paralele në konkurrimin e shpallur me kod # 4019, në Drejtorinë Juridike, në Departamentin Administrativ, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës me nr. 300 prot., datë 22.04.2022, paraqitur nga punonjësja ***** , është ngritur pretendimi se në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, kjo nëpunëse e cila aktualisht punon në pozicionin “Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”, pranë Agjencisë Rajonale të Bregdetit, Durrës, është skualifikuar për lëvizje paralele në shpalljen me kod #4019, për pozicionin “Specialist në Sektorin e Ankimeve” në Drejtorinë Juridike, në Departamentin Administrativ, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”,

miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i është kërkuar informacion Departamentit të Administratës Publike, lidhur me arsyet e skualifikimit nga konkurrimi të nëpunëses në fjalë, nëpërmjet shkresës me nr.300/2 prot., datë 03.06.2022 “Kthim përgjigje”.

Në përmbajtjen e kësaj shkrese, Departamenti i Administratës Publike, sqaron se, mbi bazën e ankesës së konkurentes, *****, depozituar në datën 15.04.2022 është kërkuar nga Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele, rishikimi i procesit të vlerësimit dhe reflektimi i nevojshëm nëse konstatohen pasaktësi në kryerjen e tij.

Në përfundim të procesit të rishikimit, Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele, pasi ka bërë rivlerësimin e elementeve të jetëshkrimit (eksperienca, trajnimet e lidhura me fushën, etj.), si dhe të intervistës së strukturuar me gojë, ka arritur përsëri në përfundimin se kandidatja në fjalë nuk rezultonte fituese, e për këtë konkluzion ka informuar edhe ankuesen.

Mbi bazën e ankimit të kandidates në fjalë për rezultatin e konkurrimit, Komisioni është mbledhur përsëri, në dt. 21.04.2022 dhe ka rishqyrtuar rezultatin e nxjerrë më parë, duke analizuar edhe një herë, të gjithë materialet e administruara. Në përfundim, ka arritur në të njëjtin përfundim në lidhje me vlerësimin (*si provë është paraqitur nga institucioni, procesverbali përkatës, i kësaj date*).

Në këto rrethana duke analizuar në tërësi dokumentacionin e administruar për këtë rast, si dhe faktet e evidentuara më sipër, arrijmë në përfundimin se gjithë veprimet administrative të njësisë përgjegjëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, janë kryer në përputhje me kërkesat e neneve 25 e 26, të ligjit nr. 152 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me kreun VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, duke respektuar hapat e kërkuar ligjorë, që nga shpallja me kriteret që duhej të plotësonin kandidatët pjesëmarrës, deri te njoftimi individualisht i kandidatëve që kanë konkurruar dhe publikimi i vendimit të përzgjedhjes së kandidatit fitues me më shumë pikë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të njësisë përgjegjëse për skualifikimin e konkurrentes ******, nga pjesëmarrja në konkurrimin e shpallur me kod #4019, për pozicionin “*Specialist në Sektorin e Ankimeve*” në Drejtorinë Juridike, në Departamentin Administrativ, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe arkivimin e çështjes, pasi nuk ekzistojnë element të shkeljeve ligjore.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësja ******.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha